

## **Procedura dhe dokumentacioni ne rast te Ndodhjes te Ngjarjes te Sigurimit**

### **Njoftimi i ngjarjes së sigurimit**

Me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit Policëmbajtësi duhet të njoftojë Siguruesin në një afat kohor sa më të shkurtër, por jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit për ngjarjen, duke specifikuar rrethanat dhe pasojat.

### **Prova e dëmtimit/humbjes**

Prova me shkrim e dëmtimit / humbjes duhet t'i jepet Siguruesit sa më shpejt të jetë e mundur, brenda 30 ditësh nga Njoftimi i Dëmtimit/Humbjes, së bashku me kopjet origjinale të të gjithë dokumentacionit përkatës. Personi i Siguruar ose Policëmbajtësi ose Perfituesi me shpenzimet e tij, do të t'i dorëzojnë Siguruesit në formën e kërkuar prej tij ato certifikata, informacione dhe të dhëna që Siguruesi do të kërkojë. Siguruesi do të ketë të drejtën por jo detyrimin që, me shpenzimet e tij, t'i kërkojë Personit të Siguruar të kryejë kontrolle mjekësore sa herë të jetë e nevojshme gjatë periudhës së trajtimit të një kërkesë për dëmshpërblim/përfitim.

SIGAL Life duhet t'i vihen në dispozicion dokumentacioni vijues për çdo ngjarje sigurimi:

### **Për 'Humbje Jete per shkaqe natyrale':**

- Certifikata e Vdekjes
- Skeda e Vdekjes
- Epikriza mjekësore të leshuar nga mjeku specialist që ka ndjekur dhe kuruar të siguarin, ku të përshkruhen me hollësi historiku sëmundjes, koha e diagnostikimit të sëmundjes, shtrimet në spital, trajtimin mjekësor, komplikacionet, sëmundjet e tjera nga i cili vuanë i siguruarit, kohën, shkaqet e vdekjes etj (firmosur nga mjeku, vulosur nga mjeku dhe institucionit shëndetësor)
- Dokumenta të tjerë mjekësorë/ligjorë nëse është e nevojshme

### **Për 'Humbje Jete per shkaqe jo natyrale':**

- Certifikata e Vdekjes
- Skeda e Vdekjes
- Akt-Ekspertimi mjeko-ligjor
- VENDIMI i Prokurorisë lidhur me ngjarjen
- Dokumenta të tjerë mjekësorë/ligjorë nëse është e nevojshme

### **Per "Paaftësi e Plotë/e Pjesëshme e Përhershme" si rrjedhojë e një aksidenti**

- Formulari I njoftimit të ngjarjes të sigurimit
- Kopje e leternjoftimit
- Fletedrejtimi për në KEMP
- Vendimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Paaftësisë në Punë (KMCP) që cakton paaftësinë e plote të përhershme dhe shkaqet e saj.
- Dokumenta të tjerë mjekësorë/ligjorë nëse është e nevojshme, përfshirë por pa u kufizuar:
  - o Kopje e karteles të shtrimit në spital nëse është shtruar në spital
  - o Procesverbal i Policisë në lidhje me aksidentin
  - o Vendim i Prokurorisë lidhur me ngjarjen

Siguruesi mund të kërkojë dokumentacion dhe prova më të detajuara në lidhje me shkallën e paaftësisë dhe shkaqet e saj

**Per “Paaftësi e Përkohshme” si rrjedhojë e një aksidenti**

- Formulari I njoftimit te ngjarjes te sigurimit
- Kopje Leternjoftimit
- Epikriza mjekesore te leshuar nga mjeku specialist qe ka ndjekur dhe kuruar te siguruarin, ku te pershkruhen historiku semundjes, koha e diagnostikimit te semundjes, shkaqet, shtrimet ne spital, komplikacionet, semundjet e tjera nga i cili vuan i sigururari, trajtimin mjekesor, rekomandimet etj (firmosur nga mjeku, vulosur nga mjeku dhe institucionit shendetesor)
- Raportet e paaftesise te perkohshme
- Dokumenta të tjerë mjekësorë/ligjorë nëse është e nevojshme, perfshire por pa u kufizuar:
  - o Kopje e karteles te shtrimit ne spital nese eshte shtruar ne spital
  - o Procesverbal i Policise ne lidhje me aksidentin
  - o Vendim i Prokurorise lidhur me ngjarjen

Siguruesi mund të kërkojë dokumentacion dhe prova më të detajuara në lidhje me shkallën e paaftësisë dhe shkaqet e saj

**Per ‘Sigurim i Shpenzimeve Spitalore nga Aksidentet’**

- Kopje e leternjoftimit (Karta ID)
- Formulari I njoftimit te ngjarjes te sigurimit
- Permbledhje e daljes nga spitali
- Dokumenta të tjerë mjekësorë/ligjorë nëse është e nevojshme, perfshire por pa u kufizuar:
  - o Kopje e karteles te shtrimit ne spital.
  - o Procesverbal i Policise ne lidhje me aksidentin
  - o Vendim i Prokurorise lidhur me ngjarjen